

NJOFTIM PËR MEDIA

Sot, më datë **24.07.2024, ora 14:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Blerona Hasa (Relatore);**
- 2. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Edlira Petri (Anëtare);**
- 5. Marsela Dervishi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.4 Regj.Themeltar, Datë 22.07.2024 Regjistrimi, me:

PADITËSE: Partia Socialiste e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Eridian Saliانji.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator në KQZ, përfaqësuar nga znj. Madalena Koja dhe z. Blendi Kodra.

PERSONA TË INTERESUAR:

- Subjekti zgjedhor "Partia Republikane Shqiptare", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia Demokristiane e Shqipërisë", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Fryma e Re Demokratike", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia e Lirisë", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia Balli Kombëtar", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Balli Kombëtar Demokrat", në mungesë;
- Subjekti zgjedhor "Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar", në mungesë.

OBJEKTI: - Kundërshtim ndaj mosmarrjes vendim nga Komisioni Rregullator në KQZ, "Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024".

- Gjykimin e çështjes në themel nga ana e Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë dhe miratimin nga ana e Kolegjit të disa

karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, sipas projektvendimit të propozuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në mbledhjen e Komisionit Rregullator të datës 19.07.2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 26, 145, 152, 153, 155, 156, 158, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

Për dijeni, Komisioni Rregullator në KQZ rezulton të ketë disponuar Vendim Nr.3 Dt. 19.07.2024 “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, në përmbajtje të të cilit është pasqyruar edhe shënimi:

“Në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, akti nuk mori numrin e kërkuar të votave për t’u konsideruar i miratuar” (3 prej anëtarëve të Komisionit Rregullator kanë votuar pro dhe 2 anëtarë kanë votuar kundër).

me Vendimin Nr.4, datë 24.07.2024, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkespadiës.
- Miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, sipas Lidhjes Nr.1, që i bashkëlidhet Projektvendimit “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, e cila bëhet pjesë integrale e këtij vendimi.
- Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin dhe publikimin e tij të menjëhershëm në faqen zyrtare të institucionit.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, më 24 të Korrikut 2024.

Tiranë, më 24.07.2024

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Disa karakteristika të fletës së votimit për kandidatët për Kryetar Bashkie për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Lloji i letrës:

Letër me thurje (Watermark) jo më pak se 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, me mikroprintime, elementë në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit

jo më e vogël se 297 mm

Orientimi i fletës së votimit:

Portret

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Ngjyra e fletës së votimit: kodi i ngjyrës:

PANTONE 7401 U

Barkodi (elementë të fshehur teknikë në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra
- Qarku 2 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e administrimit zgjedhor 2 shifra
- Numri i qendrës së votimit 6 shifra dhe elementin
ndarës “/” ndërmjet katër shifrave të para dhe dy shifrave të fundit

Elementë teknikë të lexueshëm në fletën e votimit

Zona Zgjedhore

Qendra e votimit

